




KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Gjakovë-Djakoviça-Gjakova
Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2020

Dt.30.01.2020

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 dhe 17 shkronja b të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 14 shkronja b, nenin 55 shkronja d dhe f të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenin 10.2.1 dhe 2.2, neni 11 dhe 17 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenin 31.1 dhe 31.2 të Udhëzimit Administrativ MMPH nr.01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.01.2020, pas diskutimeve lidhur me pikën e 6-të të rendit të ditës: Kërkesë për Ndryshim Plotësimin e Segmentit të Planit Rregullues Urban “Mbretëresha Teutë”, e miratoi këtë:

VENDIM

Për Ndryshim Plotësimin e Segmentit të Planit Rregullues Urban “Mbretëresha Teutë”

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton Ndryshim-Plotësimin e Segmentit të Planit Rregullues Urban “Mbretëresha Teutë”.
2. Ndryshimi dhe plotësimi i këtij segmenti i referohet katër parcelave kadastrale: P-70705029-01107-2, 01274-0, 01109-1,01109-2, 01111-0,01120-0 dhe 01121-0 Z.K. Gjakovë qytet, të cilat të grupuara sipas mundësive për realizim të planifikimit, do të realizojnë ndërtim të baras vlerësuar me ndërtimet në parcelat fqinjë.
3. Me këtë vendim ndryshimi dhe plotësimi i këtij segmenti i referohen:
 - Planifikimi i ndërtimit për parcelën e cila nuk është përfshirë në ndërtim (grupim për ndërtim) si rezultat i të dhënave jo të sakta kadastrale.
 - Ndryshimi me rritjen - plotësimin e koeficientit të shfrytëzimit të tokës nga ai aktual i planifikuar i cili varion nga 20%-35% në koeficientin e planifikuar me Planin Zhvillimor Urban dhe Komunal nga 50.0% – 60.0% (në vashëri nga pozita, shtrirja, orientimi, etj).
 - Ndryshimi me rritjen e koeficientit të ndërtimit nga ai aktual i planifikuar i cili varion nga P+6 në deri max.P+8 (në varshmëri nga pozita, shtrirja, orientimi, diellosja etj).
 - Fleksibiliteti në rigrupim të parcelave në varshmëri të mundësive të organizimit të grupit.
4. Të gjitha Elementet tjera mbesin të njëjta sipas Planit Rregullues Urban “Mbretëresha Teutë”.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës së Gjakovës.
6. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës,
 - Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
 - Arkivit,

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

z. Anton Shala

